



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

2014 - 2018

**SHTOJCA 1 – PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË
KOMBËTARE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS PËR
PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E EKONOMISË
JOFORMALE, PASTRIMIT TË PARAVE, FINANCIMIT TË
TERRORIZMIT DHE KRIMEVE FINANCIARE 2014-2018**

Janar, 2014, Prishtinë

PËRMBAJTJA

1. HYRJA	3
2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE VEPRIMET	4
2.1 Ngrija e vetëdijes për ndikimet në ekonomië joformale dhe krimeve financiare	4
2.2 Forcimi i parandalimit si dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mire dhe partneritetin social	11
2.3 Promovimi i procedurave të inteligjencës , hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare	22
2.4 Forcimi i kapaciteteve të Institucioneve Relevante	27
2.5 Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizimit dhe krimeve financiare	35
2.6 Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas	38

LISTA E SHTOJCAVE

1. Indikatorët Kyç të Performancës për Procedurat Penale të Krimeve Financiare
2. Amendamentet, Korrigjinet dhe Legjislacion Sekondar sa i përket Ligjin në Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit

1. HYRJA

Qeveria e Republikës së Kosovës ka aprovuar objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare të Republikës së Kosovës në Parandalimin e Ekonomisë Joformale, Pastrimit të Parave, Financimit të Terrorizmit dhe Krimeve Financiare 2014-2018. Ato janë siç vijon:

1. Ngrijta e vetëdijes për ndikimet në ekonomië joformale dhe krimeve financiare
2. Forcimi i parandalimit si dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mire dhe partneritetin social
3. Promovimi i procedurave të inteligjencës , hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare
4. Forcimi i kapaciteteve të Institucioneve Relevante
5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve financiare
6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas

Zbatimi i Strategjisë Kombëtare 2014-2018 është bazuar në Planin e Veprimit. Është udhërrëfyes që duhet të përcjellet në mënyrë që të arrihen objektivat strategjike. Plani i Veprimit përfshin aktivitete konkrete dhe struktura e tij përfshinë komponentet e mëposhtme:

- “Objektiva strategjike” specifikon synimin, zbatimin e të cilit e mbështesin veprimet e listuara;
- “Veprim” definojnë aktivitetin që duhet të zbatohet për të arritur objektivin strategjike;
- “Indikatorët kyq të performancës” definojnë indikatorët që janë përdorur për të matur suksesin e procesit të zbatimit të veprimit në fjalë;
- “Institucioni përgjegjës” definojnë institucionin publik që ka përgjegjësinë primare për zbatimin e veprimit në fjalë dhe është gjithashtu i obliguar të raportojë për rezultatet e procesit të zbatimit;
- “Institucionet mbështetëse” identifikojnë institucionet e sektorit publik, privat dhe të tretë që duhet t’i mbështesin institucionin përgjegjës gjatë zbatimit të veprimit në fjalë. Roli i tyre dhe përgjegjësitë duhet të specifikohen në planin që ka të bëjë me procedurën zbatuese;
- “Afati kohor për implementim” definojnë afatin për procesin e implementimit të veprimit në fjalë;
- “Kostot financiare dhe burimi i financimit” definojnë nëse procesi implementues i veprimit në fjalë kërkon fonde shtesë dhe/apo buxhet të ndare. Burimi i fondit të mundshëm duhet të specifikohet;
- “Komentet” përshkruajnë detajet e veprimit dhe synimet që kanë të bëjnë me procesin e implementimit.

Plani i Veprimit për implementimin e Strategjisë Kombëtare 2014-2018 përfshin gjithsej 51 aktivitete individuale.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE DHE VEPRIMET

2.1 Ngrijta e vetëdijes për ndikimet në ekonomië joformale dhe krimeve financiare

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
2.1.1 Krijimi i një mekanizmi të standardizuar për përgatitjen e raporteve të rregullta të gjendjes në ekonominë joformale dhe krimeve financiare në Kosovë për të mbështetur institucionet relevante në planifikimin strategjik faktik si dhe operativ dhe të komunikimit, si dhe në ngritjen e vetëdijes në mesin e shoqërisë. Raporti i Situatës duhet të publikohet dy herë për një vit kalendarik. Informatat statistikore sa i përket ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve tjera financiare janë mbledhur. Duhet të përgatiten vlerësimi i rreziqeve specifike, sondazhet, hulumtimet dhe studimet për tema që identifikohen në Raportet e gjendjes me mbështetjen e universiteteve dhe partnerëve tjerë relevantë për të përmirësuar përmbajtjen dhe cilësinë e Raporteve të rregullta të gjendjes.	Mekanizmi i standardizuar të krijohet deri më 31.1.2014 dhe procedura të rregullohet deri më 31.12.2018	Ministria e Financave	Grupi punues në nivel qeveritar dhe Sekretariati i tij, ministritë, institucionet relevante si NjIF-K, Doganat, Policia e Kosovës, Këshillit Prokurorial i Kosovës, Administrata Tatimore, sektori privat, OJQ-të, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2018	€10 000	Do të krijohet një mekanizëm i standardizuar për përgatitjen e Raportit të gjendjes për ekonominë joformale dhe pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare në Kosovë. Informatat statistikore mblidhen katër (4) herë në një vit kalendarik nga institucionet relevante përmes Sekretariatit. Përgatiten vlerësimi i rreziqeve specifike, sondazhet, hulumtimet dhe studimet bazuar në plane të ndara. Informacioni në Raportet e gjendjes për ekonominë joformale dhe krimet financiare do të përdoret për lidhje me mediat dhe marrjen e vendimeve në fushat me fokus të vlerësimit të rrezikut specifik, sondazheve, hulumtimeve dhe studimeve për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimin financiar.

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.1.2 Krijimi i funksionit të koordinimit të komunikimit dhe standardeve të bashkëpunimit me Qeverinë, autoritetet relevante dhe aktorë tjerë për komunikim me media në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për shtrirjen, shkallën, natyrën, ndikimet dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar si dhe për të rritur cilësinë e komunikimit dhe përmirësuar reputacionin e Kosovës në mënyrë që të tërheqë investitorët ndërkombëtarë.</p>	<p>Standardet e komunikimit dhe ndërgjegjësi mit të krijohen deri më 31.12.2014, funksioni i komunikimit dhe koordinimit në Ministrinë e Financave të krijohet deri më 31.12.2015 dhe procedurat të rregullohen deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>Mediat, Ministria e Financave, ministritë, institucionet përkatëse, sektori privat, OJQ-të, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Funksioni i koordinimit të komunikimit do të integrohet në Ministrinë e Financave, e cila koordinon komunikimin dhe veprimet që duhet të ndërmerren në mënyrë që të arrihet një mesazh i unifikuar dhe koherent mes palëve të ndryshme të interesit që punojnë në fushën e luftës kundër ekonomisë joformale si dhe krimit financiar dhe ekonomik.</p> <p>Është themeluar Këshilli i përfaqësuesve të palëve të interesit dhe mediave. Qëllimi është që të rritet ndëreveprimi joformal mes palëve të interesit dhe njohja nga afër me fushëveprimin e homologëve. Kryesia do të alternoj mes autoriteteve dhe mediave.</p> <p>Ministria e Financave është përgjegjëse për zbatimin e objektivave strategjike në nivel kombëtar dhe planeve të veprimit, fushatat informuese në nivel kombëtar dhe për bashkëpunimin me universitetet dhe agjencitë komerciale në mënyrë që të prodhohet materiali dhe lehtësohet trajnimi i komunikimit të autoriteteve të</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente	
						<p>ndryshme dhe organizatave të palëve të interesuara. Gjithashtu do të krijohen standarde bashkëpunimi për Qeverinë dhe autoritetet relevante për komunikim me median për të rritur ndërgjegjësimin për masën, shkallën, natyrën dhe pasojat e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare, si dhe për funksionalitetin e masave për parandalimin e krimit për të rritur cilësinë e komunikimit. Krijimi i standardeve dhe udhëzimeve të mediave sociale për të siguruar se autoritetet kanë aftësitë për të ndarë informacione dhe të ndër-veprojnë me qytetarë si dhe sektorin privat dhe të tretë. Përdorimi i mediave sociale (p.sh. blogjet, Facebook, Tëitter, dhe YouTube) është planifikuar së bashku me një universitet dhe agjenci të komunikimit.</p>	
2.1.3	Krijimi dhe zbatimi i aktiviteteve të vetëdijesimit dhe komunikimit si dhe organizimi i fushatave të ndërgjegjësimit publik mbi efektet e dëmshme si dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit	Aktivitetet e vetëdijesimit dhe komunikimit të krijohen deri më	Ministria e Financave	Grupi punues në nivel qeveritar, Ministria e Punëve të	K4 - 2018	€ 150 000	Aktivitetet e vetëdijesimit dhe komunikimit do të jenë pjesë integrale e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të saj të Veprimit 2014-2018. Të organizohen fushatat e

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>financiar. Veprimet do të nxjerrin në pah sektorët dhe degët e identifikuar në Vlerësimin e Rrezikut në nivel kombëtar për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.</p>	<p>31.1.2014 dhe të zbatohen deri më 31.12.2018</p>		<p>Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Tregtisë dhe industrisë, NjllF-K, Doganat e Kosovës, Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Administrata Tatimore dhe institucionet të tjera relevante, sindikatat, OJQ-të , Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>			<p>ndërgjegjësimit publik në bashkëpunim me si dhe për sektorin publik, privat dhe të tretë. Të identifikohen Grupet e synuara për fushatat e ndërgjegjësimit, të përgatiten planet dhe materialet për ngjarjet e ndërgjegjësimit si dhe implementimi i ngjarjeve të filluara. Veprimet do të synojnë sektorët e cenueshëm (kujdesin shëndetësor, sistemin ligjor/gjyqësor, partitë politike, qeverinë dhe kontrollit kufitar/doganor) dhe degët (biznesin e ndërtimit, biznesin e patundshmërive dhe pikat (stacionet) e karburantit).</p> <p>Është caktuar një ditë kombëtare për Luftimin e Ekonomisë joformale. Palët e interesit organizojnë ngjarje publike tek publiku i gjerë në shkolla dhe universitete, tregje, qendra tregtare etj. Qëllimi është për të diskutuar me njerëz dhe për të dhënë informacionin e duhur se si për parandalimin e ekonomisë</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						<p>joformale duke dhënë shembuj të thjeshtë si “gjithmonë kërkoni faturë” si dhe duke theksuar përgjegjësinë individuale si “Sigurohuni që të merrni një kontratë të duhur punësimit” . Materiali është planifikuar në bashkëpunim me një universitet apo agjenci të komunikimit.</p> <p>Autoritetet përgjegjëse për luftimin e ekonomisë joformale si dhe krimin financiar dhe ekonomik organizojnë ngjarje publike në baza të rregullta për të përmbushur objektivat e grupeve kryesore të synuara, për të diskutuar me ta dhe për të përhapur informata të sakta. Materialet duhet të zhvillohen në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit.</p> <p>Janë hulumtuar mundësitë për të nisur një seri televizive dokumentarësh të autoriteteve që luftojnë kundër ekonomisë joformale si dhe krimeve financiare dhe ekonomike.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						Koncepti është zhvilluar në bashkëpunim mes kanale televizive, kompanive të produksionit dhe autoriteteve.
2.1.4 Krijimi i komunikimi si pjesë integrale e kurrikulave të trajnimit të institucioneve relevante të sektorit publik, privat dhe të tretë në luftën kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar.	Trajnimi për komunikim të integruar dhe modulet e planifikuara do të dërgohen deri 30.6.2015 dhe të rregullohen deri 31.12.2015	Ministria e Financave	Grupi Punues në nivel qeveritar, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Tregtisë dhe industrisë, NjIF-K, Doganat, Policia e Kosovës, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Administrata Tatimore, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve	K2 - 2015	Jo	Departamenti i Komunikimit brenda Ministrisë së Financave do të koordinohet me institutet e trajnimit për të siguruar se komunikimi është i integruar në programet e trajnimit të institucioneve relevante të sektorit publik, privat dhe të tretë që janë të angazhuar në luftën kundër ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Ministria, në bashkëpunim me një universitet, do të lehtësojë modulin e trajnimit për udhëheqësit dhe zyrtarët për komunikim të organizatave të ndryshme të palëve të interesit. Fokusi është në vetëdijesim dhe komunikim, trajnim për media, udhëzime të komunikimit, shfrytëzimin e mjeteve sociale si dhe në planifikimin e komunikimit për të siguruar se komunikimi është marrë parasysh në planifikimin strategjik për të promovuar zbatimin efektiv.

Veprimi	Indikatorët kyç të performanc- ës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implemen tim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
			Ekonomike			

2.2. Forcimi i parandalimit si dhe luftës kundër ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke përmirësuar transparencën, llogaridhënien, qeverisjen e mire dhe partneritetin social

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.2.1 Krijimi dhe zbatimi i Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Zhvillimi i mekanizmit të standardizuar për monitorimin e procesit të implementimit dhe për rishikim të programit. Programi në nivel kombëtar duhet të fokusohet në zhvillimin e ndërgjegjësimit, parandalimit, zbulimit dhe zbatimit, ndërtimit të kapaciteteve, bashkëpunimit ndërkombëtar dhe kornizës ligjore.</p>	<p>Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit të krijohej deri më 31.1.2014 dhe të zbatohet deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Doganat, Zyra e Prokurorit të Shtetit, Administrata Tatimore, NjIF-K, Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, sektori privat, OJQ-të</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit janë krijuar, zbatuar, monitoruar dhe rishikuar programi strategjik dhe Plani i Veprimit, së bashku me institucionet relevante të sektorit publik, privat dhe të tretë në Kosovë për të përmirësimin e kapacitetit e sektorit publik dhe nxitjen e pjesëmarrjes së sektorit privat dhe të tretë.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.2.2 Nxitja e pjesëmarrjes së shoqërisë në parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar duke i përfshirë ata në krijimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar.</p>	<p>Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit të krijohen deri më 31.1.2014 dhe të zbatohen deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Doganat, Zyra e prokurorit të shtetit, Administrata Tatimore, NjllF-K, Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, sektori privat, OJQ-të</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Do të zhvillohen metodat e punës në lidhje me themelimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar për të nxitur pjesëmarrjen e shoqërisë.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.2.3 Emërimi i një Grupi Punues të nivelit qeveritar për krijimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar. Grupi Punues duhet të ndihmohet nga një sekretariat i përhershëm i cili duhet të përbëhet nga përfaqësues të nivelit të lartë të Qeverisë dhe sektorit publik, privat dhe të tretë.</p>	<p>Grupi punues dhe Sekretariati të themelohen dhe të jenë në funksion deri më 31.1.2014</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Doganat, Zyra e Prokurorit të Shtetit, Administrata Tatimore, NjIF-K, Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, sektori privat, OJQ-të</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>€5 000</p>	<p>Janë emëruar Grupi Punues i Nivelit Qeveritar dhe Sekretariati për krijimin, zbatimin, monitorimin dhe rishikimin e Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit.</p> <p>Metodat e punës së Grupit Punues të nivelit qeveritar dhe Sekretariatit të tij janë standardizuar nga Qeveria.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
2.2.4 Të bëhet një vlerësim për fushëveprimin dhe shkallën e ekonomisë joformale dhe të zezë në Kosovë e cila do të përbënte bazën për vlerësimin e ndikimeve dhe efikasitetit të veprimeve për implementimin e strategjisë dhe Planit të Veprimit.	Vlerësimi të bëhet deri më 31.12.2014	Ministria e Financave	Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Doganat, Zyra e Prokurorit të Shtetit, Administrata Tatimore, NjIF-K, Banka Qendrore e Kosovës, Policia e Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit, sektori privat, OJQ-të	K4 - 2014	Jo	Janë kryer vlerësimet më të fundit në lidhje me shkallën e ekonomisë joformale dhe të zezë në vitet 2007-2008 në Kosovë. Planifikimi strategjik dhe operativ kërkon më shumë informacion të përditësuar në lidhje me mjedisin operativ. Është e nevojshme të vlerësohet baza për masat e zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për parandalimin e ekonomisë joformale, pastrimit të parave, financimit të terrorizmit dhe krimit financiar.
2.2.5 Zgjerimi i bazës tatimore në Kosovë në mënyrë që të mbrohet interesi fiskal i shtetit, të sigurohen të drejtat e punëtorëve dhe të sigurohet konkurrenca e drejtë në sferën e biznesit.	Plani i zbatimit i hartuar deri më 31.10.2014 dhe veprimi i	Administrata Tatimore e Kosovës	Ministria e Financave, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Policia e Kosovës,	K4 - 2015	Jo	Administrata Tatimore e Kosovës dhe Ministria e Financave së bashku me Inspektoratin e Punës, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Policinë e Kosovës dhe komunat duhet të përgatisin një analizë për të

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
	zbatuar deri më 31.12.2015		komunat			<p>identifikuar rreziqet e shmangies tatimore dhe ekonomisë joformale si dhe sektorëve më të cenuara të biznesit deri më 31.10.2014. Bazuar në rezultatet e analizave, Administrata Tatimore duhet të përgatis një plan vjetor për hetimet në terren për 2015 së bashku me Ministrinë e Financave, Inspektoratin e Punës, Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Policinë e Kosovës dhe komunat deri më 31.10.2014.</p> <p>Hetimet e përbashkëta duhet të bazohen në legjislacionin ekzistues dhe mandatet, të dhënat ekzistuese të autoriteteve relevante dhe memorandumet e bashkëpunimit.</p> <p>Hetimet e përbashkëta duhet të zbatohen gjatë 2015 nga ekipet e hetimeve të përbashkëta të përbëra nga përfaqësues të Administratës Tatimore, Inspektoratit të Punës, Policisë së Kosovës dhe komunave.</p> <p>Korniza ligjore dhe instrumentet tjera relevante duhet të vlerësohen bazuar në të gjeturat e hetimeve të</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						përbashkëta dhe të amendamentohen siç kërkohet.
2.2.6 Zbatimi i Kodeve të Mirësjelljes për institucionet e sektorit publik për të siguruar transparencë, përgjegjshmëri dhe integritet. Themelimi, rishikimi dhe zbatimi i rregulloreve sektoriale për të siguruar zbatimin e Kodeve të Mirësjelljes.	Vlerësimi i nevojave të përgatitet deri më 31.12.2014 dhe aktiviteti të zbatohet deri më 31.12.2018	Ministria e Administratës Publike	Institucionet përkatëse publike	K4 - 2018	Jo	Janë zbatuar kodet e Mirësjelljes si dhe janë krijuar, rishikuar dhe zbatuar rregulloret sektoriale specifike mbi transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin në institucionet publike, sidomos në lidhje me sektorët më të cenueshëm të identifikuar në Vlerësimin e Rrezikut në nivel kombëtar për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.
2.2.7 Kryerja e një vlerësimi mbi qeverisjen korporative në ndërmarrjet publike dhe sektorin privat me qëllim të zbatimit të parimeve të qeverisjes korporative në kuadër të ndërmarrjeve.	Raporti i vlerësimit të hartohet deri më 31.12.2014	Ministria e Financave	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Oda Ekonomike,	K4 - 2014	Jo	Qeverisja e mirë përmirëson performancën e kompanive dhe aftësinë e tyre për të konkurruar si dhe mundësinë për të marrë kapital shtesë. Qeverisja e mirë rrit parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimin financiar.

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
			Universitetet			
<p>2.2.8 Krijimi i një manuali për qeverisjen korporative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të mbështetur dhe rritur performancën e tyre, mundësinë të kompletojnë dhe të marrin kapital dhe të mbështesin monitorimin dhe raportimin e KRFK-së.</p>	<p>Njësia të themelohet dhe të filloj së vepruari deri më 31.12.2014 dhe manual i qeverisjes korporative të hartohet deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Zyra e Auditorit të përgjithshëm, Oda ekonomike, universitetet</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Janë identifikuar degët e cenushme dhe janë përgatitur rregullore për degët specifike nga KRFK për të rritur qeverisjen e mirë interesin e investitorëve. Qeverisja e mirë rrit parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimit financiar.</p> <p>Krijimi i një manuali të qeverisjes korporative për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme për të rritur performancën e tyre, aftësinë për të konkurruar dhe për të marrë kapital. Do të hartohet manuali i Qeverisjes Korporative në bashkëpunim me ekspertë të KRFK ,Odën ekonomike , NJIF-K dhe Policinë e Kosovës dhe OJQ-të. Manuali do të bazohet në praktikat më të mira në këtë fushë.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.2.9 Zbatimi i inspektimeve në vendngjarje për të vlerësuar zbatimin e kodeve të etikës dhe rregullave të brendshme specifike sektoriale duke garantuar transparencën, llogaridhënien dhe integritetin në kujdesin shëndetësor, sistemin ligjor/gjyqësor, partitë politike, qeverinë, kontrollit kufitar/doganat dhe sektorë të tjerë në nevojë të identifikuar në Vlerësimin e rrezikut kombëtar për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit.</p>	<p>Inspektimi në vendngjarje të përgatite dhe zbatimi të filloj deri më 31.12.2018</p>	<p>Qeveria, Zyra e Auditorit të Përgjithshëm,</p>	<p>Ministritë, komunat</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Inspektimet për të vlerësuar zbatimin e kodeve të etikës si dhe ekzistencën dhe zbatimin e rregulloreve të brendshme të sektorit specifik duke siguruar transparencën, përgjegjshmërinë dhe integritetin në institucionet publike të identifikuara si më të rrezikuara për ekonominë joformale dhe krimet financiare. janë identifikuar Institucionet e cenueshme, planet për inspektim në vendngjarje janë përgatitur dhe inspektimet në vendngjarje kanë filluar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
2.2.10 Zbatimi i aktiviteteve mbikëqyrëse të pajtueshmërisë për të vlerësuar KPP/LFT duke raportuar pajtueshmërinë e subjekteve me ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.	Plani i mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të përgatitet dhe t[fillloi zbatimin deri më 31.12.2014 dhe veprimet të zbatohen deri më 31.12.2018	NjIF-K	Banka Qendrore e Kosovës, Autoritetet e tjera mbikëqyrëse	K4 - 2018	Jo	Aktivitete që fokusohen në sektorët më të cenueshëm (kujdesi shëndetësor, sistemi ligjor/ gjyqësor, partitë politike, qeveria dhe kontrollit kufitar/doganat) dhe degët(bizneset e ndërtimit, bizneset e patundshmërive dhe pikat (stacionet) e karburanteve) të identifikuar në Vlerësimin Rrezikut në nivel kombëtar duhet të jenë prioritet. Janë identifikuar Institucionet e cenueshme, planet për mbikëqyrjen e aktiviteteve të pajtueshmërisë të përgatitur dhe zbatimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes së pajtueshmërisë filluar nga NjIF-K.
2.2.11 Implementimi i vlerësimeve të rrezikut specifik për degën dhe sektorin, duke u fokusuar në degët dhe sektorët më të cenueshëm për sa i përket shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit. Duhet të vlerësohet dhe sigurohet pajtueshmëria e tyre me Ligjin për	Planet e vlerësimit të rrezikut specifik për degën dhe sektorin të jenë përgatitur dhe zbatimi i	NjIF-K	Banka Qendrore e Kosovës dhe autoritetet e tjera mbikëqyrëse	K4 - 2018	Jo	Institucionet e cenueshme janë identifikuar, planet vlerësimet e rrezikut specifike për degën dhe sektorin janë përgatitur dhe NjIF-K ka filluar zbatimin e tyre. Rezultatet e Vlerësimit të Rrezikut në nivel Kombëtar duhet pasur parasysh gjatë identifikimit të sektorëve dhe degëve të cenueshme.

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit.	tyre të ketë filluar më 31.12.2014 dhe Veprimi të jetë zbatuar më 31.12.2018					Informacioni i bazuar në vlerësimin e rrezikut për degën dhe sektorin do të përdoret gjatë hartimit dhe ndryshimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe gjatë kryerjes së aktiviteteve të tjera parandaluese.
2.2.12 Implementimi i vlerësimeve të rrezikut specifik për degën dhe sektorin, duke u fokusuar në degët dhe sektorët më të cenueshëm ndaj ekonomisë joformale dhe krimeve financiare më qëllim që të aplikohen masat e duhura korrektuese dhe për të siguruar pajtueshmërinë e tyre me kornizën ligjore.	Planet e vlerësimit të rrezikut specifik për degën dhe sektorin të jenë përgatitur dhe zbatimi i tyre të ketë filluar më 31.12.2014 dhe Veprimi të jetë zbatuar më 31.12.2018	Ministria e Financave	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Administrata Tatimore e Kosovës Policia e Kosovës, OJQ	K4 - 2018	Jo	<p>Institucionet e cenueshme janë identifikuar, planet vlerësimet e rrezikut specifike për degën dhe sektorin janë përgatitur dhe NjIF-K ka filluar zbatimin e tyre. Rezultatet e Vlerësimit të Rrezikut në nivel Kombëtar duhet pasur parasysh gjatë identifikimit të sektorëve dhe degëve të cenueshme.</p> <p>OJQ-të të mobilizohen për të zhvilluar studime specifike për degën dhe për intervista regjionale</p> <p>Informacioni i bazuar në vlerësimin e rrezikut për degën dhe sektorin do të përdoret gjatë hartimit dhe ndryshimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit si dhe gjatë kryerjes së aktiviteteve të</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						tjera parandaluese.
2.2.13 Caktimi i një çmimi (shpërblimi) vjetor për qeverisjen korporative për të inkurajuar kompanitë vendore që të kryejnë veprimtarinë e tyre në pajtim me parimet e qeverisjes korporative	Politika e dhënies së çmimit është themeluar deri më 31.12.2014 dhe e rregulluar deri më 31.12.2018	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	Ministria e Financave	K4 - 2018	€ 15.000	Dhënia e një çmimi vjetor do të inkurajonte kursimet vendore në tregun kapital dhe do të ndërtonte mirëbesimin e investitorëve, aksionarëve, dhe të tërë shoqërisë.

2.3. Promovimi i procedurave të inteligjencës , hetimit, ndjekjes penale, gjyqësore, dhe të zbatimit për shpëlarjen e parasë, financimit të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
2.3.1 Organizimi i NJIF-K-së për të pasqyruar detyrat dhe kërkesat e reja të agjencisë të parashikuara me ligj duke u bazuar në ambientin e tij funksionues.	Veprimi të ketë filluar më 31.12.2014 të jetë zbatuar më 31.12.2018	NjIF-K	-	K4 - 2018	Jo	Organizimi i NjIF-K kryhet për të pasqyruar detyrat dhe kërkesat e reja të agjencisë të parashikuara me ligj duke u bazuar në ambientin e tij funksionues.
2.3.2 Alokimi i duhur i burimeve për NJIF-K, Bankën Qendrore, Doganat dhe Administratën Tatimore për të siguruar zbatimin e plotë të Ligjit të ndryshuar për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit	Kërkesat e NJIF-K-së, Bankës Qendrore dhe Administratës Tatimore për burime të jetë përcaktuar dhe ndarja e burimeve të ketë filluar deri më 31.12.2014 dhe Veprimi të jetë zbatuar deri më 31.12.2018	Ministria e Financave	NjIF-K, Banka Qendrore, Administrata Tatimore, Doganat	K4 - 2018	€ 25 000	NjIF-K, Banka Qendrore, Doganat dhe Administrata Tatimore duhet të kenë burime që janë në pajtim me kërkesat e reja të Ligjit për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit, veçanërisht për sa i përket mbikëqyrjes së pajtueshmërisë.

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
2.3.3 Krijimi i Procedurave Standarde Operative për aktivitetet e mbikëqyrjes së pajtueshmërisë të NJIF-K.	Veprimi të ketë filluar dhe të jetë zbatuar deri më 31.12.2014	NJIF-K	BQK	K4 - 2014	Jo	Procedurat Standarde Operative për mbikëqyrjen e pajtueshmërisë do të përforconte funksionet e NJIF-K -së.
2.3.4 Të sigurohet që hetimet financiare, identifikimi dhe gjurmimi i krimit si dhe përdorimi i masave të përkohshme të sekuestrimit janë integruar në mënyrë sistematike në planifikimin e çdo hetimi penal, duke krijuar Procedura Standarde Operative në lidhje me planifikimin e krimeve të rënda dhe të ndërlikuara	Standardet të jenë hartuar dhe implementimi të ketë filluar deri më 31.12.2014	Policia e Kosovës	Doganat, NJIF-K, Zyra e Prokurorit të Shtetit Administrata Tatimore Agjencia Kundër Korrupsionit, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2014	Jo	Hetimet financiare, identifikimi dhe gjurmimi i krimit si dhe përdorimi i masave të përkohshme të sekuestrimit duhet të përdoren në mënyrë sistematike në fazën sa më të hershme të mundshme të veprës penale, duke i ndihmuar kështu hetimeve që të argumentojnë qartë faktet e rastit dhe të lehtësojnë aktvendimet e prera të gjyimit për krimet e kryera. Prokurorët, policia, Doganat and Administrata Tatimore duhet të hartojnë Procedura Standarde Operative të përbashkëta në lidhje me planifikimin e krimeve të rënda dhe të ndërlikuara, duke përfshirë hetimet financiare.

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
2.3.5 Hartimi i Procedurave Standarde Operative lidhur me Task Forcën e Përbashkët të Inteligjencës dhe proceset e përbashkëta të zbulimit për autoritetet e zbatimit të ligjit me qëllim që të rritet bashkëpunimi strategjik dhe operativ dhe koordinimin e hetimeve të krimit financiar si dhe për të zhvilluar metoda për prioritizimin e krimeve më të rënda financiare.	Standardet të jenë hartuar dhe implementimi të ketë filluar deri më 31.12.2014 dhe veprimi të jetë zbatuar deri më 31.12.2018	Policia e Kosovës	Doganat, NjIF-K, Zyra e Prokurorit të Shtetit Administrata Tatimore Agjencia Kundër Korrupsionit, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2018	Jo	Krijimi i Task Forcës së Përbashkët të Inteligjencës me pjesëmarrje nga të paktën Policia e Kosovës, Doganat, NjIF-K, Prokuroria Publike, Administrata Tatimore dhe Agjencia Kundër Korrupsionit. Operacioni i Task Forcës duhet të bazohet në procedura të standardizuara. Ajo do të zëvendësonte funksionet e zyrtarit ndërlidhës dhe do të kursente burimet meqenëse analiza e inteligjencës do të ofrohej për autoritetet e zbatimit të ligjit nga një pikë që konsiston në ekspertizën e nevojshme kombëtare dhe qasjen në bazat e të dhënave të autoriteteve përkatëse
2.3.6 Krijimi i një Procedure me Synim të Përbashkët në mënyrë që autoritetet e zbatimit të ligjit dhe prokurorët të identifikojnë krimet e rënda financiare dhe të tjera, të prioritizojnë hetimet e tyre, të bien dakord për përgjegjësitë	Standardet të jenë hartuar dhe implementimi të ketë filluar deri më 31.12.2014	Policia e Kosovës	Doganat, NjIF-K, Zyra e Prokurorit të Shtetit Administrata Tatimore Agjencia	K4 - 2018	Jo	Krijimi i një procedure të standardizuar të përzgjedhjes për objektivat e krimeve të rënda në mënyrë që të bëjë parandalimin e krimeve më të rënda financiare më efektive, të ulë

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
operative dhe të rrisin bashkëpunimin dhe koordinimin.	dhe veprimi të jetë zbatuar deri më 31.12.2018		Kundër Korrupsionit, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike			mbivendosjen e aktiviteteve dhe që zbatimi i ligjit të ketë kosto efektive ku do të përdorej stafi i specializuar i autoriteteve të ndryshme për hetimin e prioritizimin e rasteve.
2.3.7 Futja në përdorim e procedurës së standardizuar për themelimin e ekipeve hetimore nga shumë agjenci në mënyrë që të rritet efikasiteti operative, bashkëpunimi dhe bashkërendimi	Standardet të jenë hartuar dhe implementimi të ketë filluar deri më 31.12.2014 dhe veprimi të jetë zbatuar deri më 31.12.2018	Policia e Kosovës	Doganat, NjIF-K, Zyra e Prokurorit të Shtetit Administrata Tatimore Agjencia Kundër Korrupsionit Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2018	Jo	Procedura e standardizuar për themelimin e ekipeve hetimore nga shumë agjenci do të përgatitet me qëllim që të bëjë parandalimin dhe hetimin e krimeve më të rënda financiare më efektive, të ulë mbivendosjen e aktiviteteve dhe që zbatimi i ligjit të ketë kosto efektive ku do të përdorej stafi i specializuar i autoriteteve të ndryshme për hetimin e prioritizimin e rasteve
2.3.8 Themelimi i një Njësie për Gjurmimin e Pasurive në kuadër të Policisë së Kosovës, Doganave dhe Administratës Tatimore në mënyrë që të forcohet gjurmimi dhe konfiskimi i të ardhurave nga krimi.	Njësia të jetë themeluar dhe veprimtaria të ketë filluar deri më 31.12.2014 dhe veprimi të jetë	Policia e Kosovës, Doganat, Administrata Tatimore e Kosovës	Ministria e Punëve të brendshme, Ministria e Financave, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve	K4 - 2018	Jo	Një funksion i veçantë për gjurmimin e pasurive në kuadër të Policisë së Kosovës, Doganave dhe Administratës Tatimore do të rriste gjurmimin dhe kthimin e të ardhurave nga krimet e rënda financiare dhe të tjera. Proceset e punës së këtyre

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
	zbatuar deri më 31.12.2018		Ekonomike			funsioneve duhet të jenë të standardizuara përmes një Procedure Standarde Operative. Njësia për Rikthimin e Pasurive në kuadër të Policisë së Kosovës do të veprojë si një Zyrë për Rikthimin e Pasurive (ZRP) siç përcaktohet me Vendimin 2007/845/JHA e Këshillit të Bashkimit Evropian, datë 6 dhjetor 2007

2.4. Forcimi i kapaciteteve të Institucioneve Relevante

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.4.1 Përmirësimi i Performancës, Buxhetit dhe Procedurave për Planifikimin e Burimeve Njerëzore të autoriteteve relevante duke zhvilluar planifikimin strategjik dhe shpërndarjen e burimeve. Për të rritur, monitoruar dhe matur efikasitetin e inteligjencës, gjurmimin e pasurive, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale, masat shtrënguese, procedurat gjyqësore dhe zbatimin e masave në lidhje me krimet e financiare është e rëndësishme që të vendosen objektivat dhe treguesit kyç të performancës të besueshme. Shpërndarjen e burimeve duhet të lidhen me përcaktimin faktik të objektivit. Procesi penal duhet të ndahet në tri faza të cilat janë hetimet e procedurës paraprake, prokuroria dhe procedurat gjyqësore. Ata të gjithë duhet të kenë objektiva specifike dhe tregues kyç të performancës lidhur me krimet financiare.</p>	<p>Procedurat e planifikimit të performancës të jenë hartuar dhe zbatuar deri më 31.12.2014 dhe veprimi të jetë zbatuar deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Punëve të brendshme, Ministria e Financave</p>	<p>Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës, NjIF-K, Zyra e Prokurorit Publik, Administrata Tatimore, Agjencia Anti Korrupsion, Agjencia për menaxhimin e pasurisë së konfiskuar dhe sekuestruar, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Drejtimi i aktiviteteve strategjike dhe operativ të autoriteteve të ndryshme është e nevojshme për të garantuar ndarjen efikase të fondeve dhe burimeve publike. Për të përmirësuar inteligjencën, gjurmimin e pasurisë, zbulimin, hetimin, ndjekjen penale, masat shtrënguese, procedurat gjyqësore dhe masat e zbatimit në lidhje me krimet financiare, procedurat e buxhetimit dhe planifikimit, performanca e institucioneve publike përkatëse duhet të jenë të standardizuara dhe të zhvilluara për të siguruar vendosjen e përbashkët të objektivave.</p> <p>Procesi penal duhet të ndahet në hetime paraprake, procedura të prokurorisë dhe të gjykatës. Ato të gjitha duhet të kenë objektiva specifike dhe tregues kyç të performancës lidhur me krimet financiare. Ata janë</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						të identifikuar në Aneksin 1 të Planit të Veprimit
<p>2.4.2 Zhvillimi i trajnimit sa i përket parandalimit dhe zbulimit të ekonomisë joformale dhe krimeve financiare duke adoptuar legjislacion sekondar që definojnë mandatin, përgjegjësinë dhe strukturën e Institutit të Krimeve Ekonomike.</p> <p>Nënshkrimi i Memorandumit të Mirëkuptimit mes Policiës së Kosovës, Doganave të Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës, Akademisë së Kosovës për Siguri Publike dhe institucioneve tjera kontribuese që të pajtohen për organizimin dhe burimet sa i përket Institutit të Krimeve Ekonomike.</p>	<p>Legjislacioni sekondar sa i përket Institutit të Krimeve Ekonomike i adoptuar dhe Memorandumet e Mirëkuptimit e nënshkruara me institucioneve kontribuese</p>	<p>Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Brendshme</p>	<p>Koordinatori Kombëtar, Policia e Kosovës, Doganat e Kosovës, Administrata Tatimore e Kosovës, NjIF-K, Agjencia Anti-Korrupsion e Kosovës, Banka Qendrore e Kosovës, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Instituti</p>	<p>K2 – 2014</p>	<p>€ 3 000</p>	<p>Strategjia në Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit 2012-2015 kërkon themelimin e Institutit të Krimeve Ekonomike si funksion koordinues për trajnimet e krimeve ekonomike. Instituti i Krimeve Ekonomike ka filluar trajnimet në 2013. Në mënyrë që të formalizohet procesi i themelimit të Institutit të Krimeve Ekonomike, është e nevojshme të definohet mandati i tij, përgjegjësitë dhe struktura. Memorandumet e Bashkëpunimit kërkohet të nënshkruhen me institucionet kontribuese për të siguruar burime njerëzore dhe financiare për Institutin e Krimeve Ekonomike dhe për të definuar shërbimet e</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
			Gjyqësor i Kosovës.			trajnimeve kërkohet nga Instituti i Krimeve Ekonomike të ofroj kontribut në institucionet publike.
2.4.3 Krijimi i Strategjisë dhe Programit për vlerësimin e nevojave të përbashkëta për institucionet përkatëse të sektorit publik, privat dhe sektorit të tretë në lidhje me parandalimin dhe zbulimin e ekonomisë informale dhe krimeve financiare. Aranzhimet e trajnimit duhet të pasqyrojnë rezultatet e Vlerësimit të Rrezikut në nivel Kombëtar mbi Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit 2013	Strategjia dhe Programi për Vlerësimin e Nevojave për Trajnim të jetë hartuar deri më 31.1.2014 dhe procedura të jetë rregulluar deri më 31.12.2018	Instituti i Krimeve Ekonomike	Ministritë relevante, Instituti i Krimeve Ekonomike, Instituti Gjyqësor i Kosovës, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike dhe përfaqësuesit e sektorit të tretë	K4 - 2018	€30 000	Programi i Trajnimit duhet të hartohet, zbatohet, vlerësohet, dhe rishikohet në bashkëpunim mes koordinatorëve të trajnimit të institucioneve publike relevante, Instituti për Krime Ekonomike, Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK), Akademia Kosovare për Siguri Publike (AKSP) Instituti Kosovar për Administratë Publike (IKAP) dhe përfaqësues relevant të sektorit privat dhe atij të tretë. Objektivi është rritja e kapacitetit të sektorit publik dhe promovimi i pjesëmarrjes së sektorit privat dhe atij të tretë.

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.4.4 Krijimi i procedurës së standardizuar për rekrutimin, trajnimin dhe certifikimin e policëve dhe ekspertëve të tjerë për t'u autorizuar që të kryejnë Analizë Kompiuterike siç përcaktohet në nenin 147 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (No. 04/L-123). Procesi i punës së analistëve kompiuteristik të autorizuar duhet të standardizohet përmes një Procedure Standarde Operimi.</p>	<p>Procedura e standardizuar për rekrutimin trajnimin dhe certifikimin e analistëve kompiuteristik të autorizuar të jetë hartuar deri më 30.4.2014, Standard Procedura Standarde e Operimit on për Procesin e punës së analistëve kompiuteristik të jetë hartuar deri më 30.6.2014 dhe Analisti i parë Kompiuteristik të jetë rekrutuar, trajnuar dhe</p>	<p>Qeveria</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës, Prokurorët, Gjykatat NjIF-K, Doganat e Kosovës, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Instituti i Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Neni 147 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës kërkon që çdo shqyrtim ose analizë financiare e përcaktuar sipas nenit të sipër përmendur ti nënshtrrohet rregullave të analizës së ekspertit dhe dëshmisë sipas neneve 136-142 të i Kodit të Procedurës Penale. Prokurori i shtetit mund të autorizojë një polic ose ekspert për të analizuar, ekzaminuar dhe hulumtojë informacioni ose të dhënat që gjenden në një kompjuter, mjetet e ruajtjes elektronike ose pajisje të ngjashme. Eksperti i autorizuar duhet të ketë arsimin, trajnimin ose përvojë në analiza dhe hulumtime forensike kompjuterike.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
	certifikuar deri më 31.12.2014					
<p>2.4.5 Krijimi i procedurës së standardizuar për rekrutimin, trajnimin dhe certifikimin e policëve dhe ekspertëve të tjerë për t'u autorizuar që të kryejnë Analizë Financiare siç përcaktohet në nenin 148 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës (No. 04/L-123). Procesi i punës së analistëve kompjuteristik të autorizuar duhet të standardizohet përmes një Procedure Standarde Operimi.</p>	<p>Procedura e standardizuar për rekrutimin trajnimin dhe certifikimin e analistëve financiar të autorizuar të jetë hartuar deri më 30.4.2014, Standard Procedura Standarde e Operimit për Procesin e punës së analistëve financiar të jetë hartuar deri më 30.6.2014 dhe Analisti i parë Financiar të</p>	<p>Qeveria</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Akademia e Kosovës për Siguri Publike, Policia e Kosovës, Prokurorët, Gjykatat, NjIF-K, Doganat e Kosovës, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike, Instituti i Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Neni 148 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës kërkon që çdo shqyrtim ose analizë financiare e përcaktuar sipas nenit të sipër përmendur ti nënshtrohet rregullave të analizës së ekspertit dhe dëshmisë sipas neneve 136-142 të i Kodit të Procedurës Penale. Polici ose eksperti i autorizuar duhet të ketë arsimin, trajnimin ose përvojë në analiza financiare dhe kontabilitet</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
	jetë rekrutuar, trajnuar dhe certifikuar deri më 31.12.2014					
<p>2.4.6 Rritja e kualitetit të procedurave penale dhe kapacitetit të autoriteteve relevante përmes</p> <ul style="list-style-type: none"> Kryerjes së një vlerësimi dhe sigurimit të qasjes në kohë në të dhëna të Regjistrimit Civil për NjIF-K, Policinë e Kosovës, Doganat e Kosovës, Administratën Tatimore, Prokurorët dhe Gjykatat; Organizimi i ndërlidhjes teknike mes NjIF-K, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës, Administratës Tatimore, Prokurorëve dhe gjykatave në databazën e Regjistrimit Civil; Kryerjen e një vlerësimi dhe organizimi teknik në lidhjen e sistemeve të TI mes NjIF-K, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës, Administratës Tatimore, Prokurorëve dhe Gjykatave në 	<p>Vlerësimi të jetë kryer deri më 31.12.2015 dhe zgjidhja teknike të jetë zbatuar deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Policia e Kosovës, Prokurorët, Gjykatat, NjIF-K, Doganat, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>Jo</p>	<p>Është e rëndësishme nga këndvështrimi i parimeve të ligjshmërisë të sigurohet se procedurat penale prekin personat e duhur. Qasja në kohë në të dhënat e Regjistrimit Civil është pjesë esenciale e këtij procesi. Në anën tjetër, zbatimi i masave për zbatimin e ligjit dhe autoritetet gjyqësore për parandalimin e krimit duhet të jenë të lidhura. Kjo është një domosdoshmëri për të drejtuar masat zbatuese operative dhe strategjike, hetimin e krimit të synuar, alokimin efektiv të burimeve, mbrojtjen e të dhënave dhe procesin e duhur ligjor. Prandaj</p> <ul style="list-style-type: none"> Autoritetet e zbatimit të ligjit dhe autoritetet gjyqësore duhet të kenë qasje në kohë në Regjistrin Civil;

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
kuptimin e shkëmbimit të informative dhe marrjes së përgjigjeve.						<ul style="list-style-type: none"> • Baza e të dhënave e autoriteteve të ndryshme të zbatimit të ligjit, prokurorëve dhe gjykatave duhet të jenë të lidhura; • Zgjidhjet e ndërlidhura të TI duhet të mundësojnë raportimin nga autoritet e zbatimit të ligjit tek gjyqësori dhe reagimet nga gjyqësori tek autoritetet e zbatimit të ligjit në lidhje me vendimet e marra gjatë shqyrtimit të akuzave dhe procedurave gjyqësore. <p>Një parakusht është se qasja në bazën e të dhënave të një autoriteti tjetër është e kufizuar. Informacioni dhe përdoruesit duhet të kategorizohen dhe qasja do të varet nga kategorizimi.</p> <p>Një vlerësim në kërkesat teknike dhe ligjore për ndërlidhje të databazës duhet të bëhet nga autoritetet</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						<p>vendore.</p> <p>Krijimi i ndërlidhjes teknike mes NjIF-K, Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës, Administratës Tatimore, Prokurorëve dhe sistemeve të TI-së së Gjykatave në kontekstin e shkëmbimit të informacionit dhe përgjigjeve.</p>
<p>2.4.7 Kryerja e vlerësimit të parakushteve ligjore dhe teknike për regjistrimin e biznesit, zbatimi i së cilës është thelbësore për të rritur cilësinë dhe besueshmërinë e informacionit të së regjistrimit të biznesit.</p>	<p>Vlerësimi të jetë kryer deri më 31.12.2014 dhe aktiviteti të zbatohet deri më 31.12.2018</p>	<p>Ministria e Tregtisë dhe Industrisë</p>	<p>Agjencia e Regjistrimit të Biznesit në Kosovë, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>€15 000</p>	<p>Aktivitetet e biznesit nuk mund të kryhen kudo në Kosovë, përveç se nga një organizatë tregtare e Kosovës ose shoqëri tregtare e huaj që ka qenë e regjistruar në Regjistrin e Bizneseve. Për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare është shumë e rëndësishme që shërbimet e Regjistrimit të Bizneseve të jenë lehtë të qasshme dhe informacioni i regjistruar në regjistër të jetë i saktë dhe i përditësuar.</p>

2.5. Zhvillimi dhe aplikimi i qasjes pro-aktive karshi bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e pastrimit të parave, financimit të terrorizimit dhe krimeve financiare

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.5.1 Sigurimi i anëtarësimit të NjIF-K-së në Grupin Punues Rajonal të NjIF-ve në rajon për ta rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi.</p>	<p>Veprimi ka filluar dhe zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>NjIF-K</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe të krimet e tjera financiare janë krime tejkufitare. Puna e rrjetit të NjIF/ve rajonale duhet të zhvillohet në bazë të një plani të veçantë të punës (afat shkurtër/mesme/afatgjatë) për të garantuar bashkëpunimin efektiv ndërkombëtar.</p>
<p>2.5.2 Sigurimi i anëtarësimit të NjIF-K-së në Grupin Egmont të Njësive të Inteligjencës Financiare për të rritur shkëmbimin ndërkombëtar të inteligjencës financiare dhe për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi.</p>	<p>Veprimi ka filluar dhe zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>NjIF-K</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>K4 - 2018</p>	<p>€ 15 000</p>	<p>Pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet e tjera financiare janë krime tejkufitare. Efikasiteti i parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është i bazuar në këmbim të besueshëm dhe në kohë të informacionit operativ ndërmjet NjIF-ve. Anëtarësimi i NjIF-K-së në Grupin Egmont do të sigurojë zgjidhje të tilla teknike.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.5.3 Sigurimi i bashkëpunimit operativ të NJIF-K-së me NjIF-të e huaja përkatëse përmes nënshkrimit të Memorandumeve të Mirëkuptimit për rritjen e shkëmbimit ndërkombëtar të inteligjencës financiare për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi.</p>	<p>Veprimi ka filluar dhe zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>NjIF-K</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Pastrimi i parave, financimi i terrorizmit dhe krimet e tjera financiare janë krime tejkufitare. Efikasiteti i parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është i bazuar në këmbim të besueshëm dhe në kohë të informacionit operativ ndërmjet NjIF-ve. Pasi NjIF-K nuk është anëtare e Grupit Egmont, është e rëndësishme për të rënë dakord me homologët ndërkombëtar relevant rreth zgjidhjeve për shkëmbimin e informacioneve.</p>
<p>2.5.4 Zhvillimi i bashkëpunimit strategjik dhe operativ ndërkombëtar ndërmjet autoriteteve rajonale për zbatimin e ligjit dhe ato gjyqësore për të rritur parandalimin dhe zbulimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare dhe serioze përmes sigurimit të anëtarësimit në Grupet Punuese Rajonale përkatëse dhe duke</p>	<p>Veprimi ka filluar dhe zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>Policia e Kosovës</p>	<p>Doganat e Kosovës, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Efikasiteti i parandalimit dhe zbulimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është i bazuar në këmbim të besueshëm dhe në kohë të informacionit operativ ndërmjet autoriteteve relevante për zbatimin e ligjit dhe atyre gjyqësore. Kosova nuk është anëtare e organizatave më të</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
krijuar plane të përbashkëta të punës me përcaktim të objektivit.						rëndësishme ndërkombëtare të themeluara për parandalimin e krimit. Prandaj, është e rëndësishme për të rënë dakord me homologët ndërkombëtar relevant rreth zgjidhjeve për shkëmbimin e informacioneve dhe marrëveshjet operative.

2.6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe sigurimi i zbatimit të tij efikas

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.6.1 Sigurimi i zbatimit të plotë dhe të drejtë të Ligjit për Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me Rekomandimet e TFAF duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistematizuar strukturën dhe përmbajtjen e tij; • Ndryshuar dispozitat; • Korrigjuar gabimet teknike; • Miratuar legjislacionin sekondar. 	<p>Veprimi ka filluar dhe zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>Ministria e Financave</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, NjIF-K, Koordinator i Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Ligji për Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit është në pjesën më të madhe në pajtim me Rekomandimet e TFAF. Megjithatë, institucionet e sektorit publik, privat dhe të treta e konsiderojnë ligjin si vështirë të aplikueshëm. Prandaj, ligji duhet sistematizuar. Për më tepër, mangësitë dhe gabimet teknike kërkojnë ndërmarrjen e ndryshimeve dhe korrigjimeve të përcaktuara në Shtojcën 2.</p> <p>Zbatimi i tij i plotë do të sigurohet edhe me nxjerrjen e legjislacionit sekondar i cili është identifikuar poashtu në Shtojcën 2 të Planit të Veprimit.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.6.2 Sigurimi i zbatimit efektiv të sanksioneve ndërkombëtare që në shënjestër kanë terrorizmin dhe financimin e terrorizmit, si dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë përmes rishikimit të Ligjit për Zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare, duke siguruar ngrirjen e fondeve dhe të pasurive siç kërkohet me sanksione ndërkombëtare dhe duke e sanksionuar dështimin për t'iu bindur sanksioneve ndërkombëtare në Kodin Penal.</p>	<p>Veprimi ka filluar dhe zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>Ministria e Punëve të jashtme</p>	<p>Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Ligji për Zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare është ligj i përgjithshëm që përshkruan zbatimin e sanksioneve ndërkombëtare. Edhe pse ligji si i tillë është në përputhje me Rekomandimet e TFAF, ai nuk përshkruan në detaje të mjaftueshme masat praktike të zbatimit në lidhje me ngrirjen e fondeve dhe asetëve si dhe kërkesat e tjera të Rekomandimeve. Kodi Penal i Kosovës nuk i sanksionon në mënyrë eksplicite shkeljet e sanksioneve ndërkombëtare.</p>
<p>2.6.3 Sigurimi i pajtueshmërisë së Kodit të Procedurës Penale me Rekomandimet e TFAF duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Siguruar përdorimin e masave të fshehta ndërhyrëse dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit për hetimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit; 	<p>Veprimi zbatohet deri më 31.12.2014</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Ministria e Punëve të Brendshme, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2014</p>	<p>Jo</p>	<p>Vepra penale e financimit të terrorizmit duhet të përfshihet në listën e veprave penale në nenin 90 të Kodit të Procedurës penale për të lejuar përdorimin e masave të fshehta dhe teknike ndërhyrëse të vëzhgimit dhe hetimit për hetimin e këtij</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<ul style="list-style-type: none"> • Siguruar ngrirjen e fondeve që janë të ndërlidhura me financimin e terrorizmit; • Siguruar sekuestrim të përkohshëm të bazuar në vlerë, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin e të ardhurave nga krimi; • Zgjeruar fushëveprimin e dorëzimit të kontrolluar. 						<p>krimi.</p> <p>Paragrafi 1.2.42 i nenit 90 të Kodit të Procedurës penale lejon përdorimin e masave hetimore të fshehta dhe teknike për hetimin e pastrimit të parave. Megjithatë, paragrafi i lartpërmendur i referohet nenit 307 të Kodit Penal. Ky është një gabim teknik që duhet të korrigjohet. Sanksionimi i pastrimit të parave është paraparë në nenin 308 të Kodit Penal.</p> <p>Ngrirja e fondeve të ndërlidhura me financimin e terrorizmit duhet të sigurohet duke vendosur financimin e terrorizmit në listën e veprave penale në nenin 90 të Kodit të Procedurës penale duke mundësuar kështu ngrirjen siç përcaktohet në nenin 264 të Kodit të Procedurës Penale për tu aplikuar për fondet të cilat kanë për qëllim të përdoren për financimin e</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						<p>terrorizmit.</p> <p>Referenca ndaj mundësisë për sekuestrimin e përkohshëm të bazuar në vlerë, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin siç përcaktohet në nenet 105-118 dhe 277 të Kodit të Procedurës penale nuk është në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë eksplicite. Nenet 105-118 dhe 277 të Kodit të Procedurës penale duhet të ndryshohen për të përfshirë sekuestrimin e përkohshëm të bazuar në vlerë, konfiskimin e përkohshme dhe konfiskimin.</p> <p>Neni 91 i Kodit të Procedurës penale përcakton se dorëzimi i kontrolluar është i lejuar vetëm për dërgesat postare. Fushëveprimi i dorëzimit të kontrolluar duhet të zgjerohet për të siguruar</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						përdorimin e tij efikas për hetimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Paragrafi 2.10 i nenit 91 të Kodit të Procedurës penale duhet të ndryshohet për të zgjeruar fushëveprimin e dorëzimit të kontrolluar.
2.6.4 Sigurimi i pajtueshmërisë së Kodit Penal me Rekomandimet e TFAF duke ndryshuar sanksionimin e financimit të terrorizmit dhe duke ndryshuar nenin 97 të Kodit Penal në mënyrë që të përshkruhet në mënyrë të qartë përdorimi i plotë i konfiskimit të bazuar në vlerë.	Veprimi zbatohet deri më 31.12.2014	Ministria e Drejtësisë	NjIF-K, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2014	Jo	<p>Sanksionimi i financimit të terrorizmit është përfshirë në nenin 36.B të Ligjit për Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe në nenin 138 të Kodit Penal. Përkufizimet e financimit të terrorizmit janë të ndryshme në këto dy nene.</p> <p>Sanksionimi i financimit të terrorizmit duhet të përfshihet në Kodin Penal dhe përmbajtja e tij duhet të ndryshohet në përputhje me Konventën ndërkombëtare mbi financimin e terrorizmit.</p> <p>Referenca për mundësinë për konfiskimin e bazuar në vlerë në nenin 97 të Kodit</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						Penal nuk është në pajtim me standardet ndërkombëtare. Kjo duhet të jetë e përcaktuar në mënyrë eksplicite. Artikulli 97 duhet të ndryshohet për të përfshirë konfiskimin e bazuar në vlerë.
<p>2.6.5 Vlerësimi ligjor për të rishikuar Kodin e Procedurës Penale dhe të sigurimi i zbatimit të tij të plotë, duke:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sistematizuar strukturën dhe përmbajtjen e tij; • Hartimin e udhëzimeve administrative ose procedurave standarde operative; • Harmonizimin e sistemit ligjor të aplikuar. 	Veprimi zbatohet deri më 31.12.2018	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2014	Jo	<p>Autoritetet për zbatimin e ligjit dhe ato gjyqësore konsiderojnë Kodin e Procedurës penale si vështirë të aplikueshëm. Kjo ka të bëjë veçanërisht me sekuestrimin e përkohshëm, konfiskimin e përkohshëm dhe konfiskimin. Prandaj, duhet të vlerësohet nëse funksionaliteti i ligjit kërkon rishikime ose amendamente ose nëse interpretimi i ligjit mund të korrigjohet duke nxjerrë udhëzime administrative ose procedura standarde operative.</p> <p>Sistemi juridik në Kosovë është duke evoluuar dhe aktualisht përbënë një</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						<p>përzierje të ligjeve që rrjedhin nga sistemet e ndryshme ligjore. Legjislacioni është i bazuar kryesisht në të drejtën civile, por në vitet e fundit hartimi i projektligjeve në Kosovë përveç kësaj ka qenë e ndikuar edhe nga tradita të tjera të ligjeve. Ky kombinim i burimeve për sistemin ligjor në Kosovë, komplikon ligjin penal dhe shkakton mospërputhje pasi detajet e legjislacionit ndryshojnë, edhe brenda ligjeve individuale, duke e ndërlikuar zbatimin e disa ligjeve të caktuara.</p> <p>Hartimet e ligjeve në të ardhmen, të paktën përkitazi me procesin penal, duhet të bazohen në një sistem ligjor të harmonizuar dhe të aplikuar në mënyrë koherente.</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>2.6.6 Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për Zyrën e Prokurorit të Posaçëm në lidhje me hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.</p>	<p>Veprimi zbatohet deri më 31.12.2015</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Zyra e Prokurorit Të Posaçëm, Këshilli Prokurorial i Kosovës, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2015</p>	<p>Jo</p>	<p>Neni 3 i Ligjit për Parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit thekson se veprat penale të përcaktuara me ligj bien në kompetencë ekskluzive të Zyrës së Prokurorit të posaçëm të Republikës së Kosovës.</p> <p>Neni 5 i Ligjit për Zyrën e Prokurorit të posaçëm të Republikës së Kosovës përcakton mandatin e prokurorëve të posaçëm. Për sa i përket pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, ligji i referohet Kodit të Procedurës penale dhe Kodit Penal të cilët janë shfuqizuar.</p> <p>Rekomandohet që neni 5 i Ligjit për Zyrën e Prokurorit të posaçëm lidhur me hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit duhet të rishikohet për ti bërë referencë të drejtë</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						legjislacionit në fuqi.
2.6.7 Sigurimi i konfiskimit efikas të fondeve të përcaktuara apo përdorura për financimin e terrorizmit duke përfshirë edhe sanksionimin e terrorizmit dhe financimit të terrorizmit në fushëveprimin e Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale.	Veprimi zbatohet deri më 31.12.2015	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Brendshme, NjIF-K, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2015	Jo	Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale përcakton kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar nga persona të cilët kanë kryer vepër penale, ndërsa procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurës penale nuk janë të mjaftueshme. Ligji nuk mbulon sanksionimin e terrorizmit ose të financimit të terrorizmit. Ligji për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së përfituar me vepër penale duhet të ndryshohet për ti përfshirë edhe këto vepra.
2.6.8 Rritja e asistencës së ndërsjellë ligjore në çështjet penale me ndryshimin e Ligjit për Bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale	Veprimi zbatohet deri më 31.12.2015	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Jashtme, Koordinatori Kombëtar	K4 - 2015	Jo	Rekomandimi 37 i TFAF kërkon që vendet duhet të ofrojnë asistencë të ndërsjellë ligjore, pavarësisht mungesës së

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
<p>për të përfshirë një dispozitë që lejon asistencën vendeve tjera pavarësisht mungesës së kriminalitetit të dyfishtë, në qoftë se ndihma nuk përfshin veprime shtrënguese.</p>			<p>për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>			<p>kriminalitetit të dyfishtë, në qoftë se asistenca nuk ka të bëjë veprime shtrënguese. Nenet 72 dhe 85 të Ligjit për Bashkëpunim juridik ndërkombëtar në çështjet penale duhet të ndryshohen në përputhje me rrethanat.</p>
<p>2.6.9 Rritja e zbatimit të legjislacionit duke krijuar qasje në materialet për hartimin e projektligjeve si dhe praktikat e adekuate ligjore.</p>	<p>Veprimi zbatohet deri më 31.12.2016</p>	<p>Ministria e Drejtësisë</p>	<p>Ministria e Punës Jashtme, Koordinator Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike</p>	<p>K4 - 2016</p>	<p>Jo</p>	<p>Nuk ka qasje të besueshme dhe gjithëpërfshirëse në materialet për hartimin e ligjeve apo praktikat ligjore relevante përfshirë informacionet mbi rezultatin e hetimeve paraprake, informacione në lidhje me procedurën gjyqësore ose vendimet gjyqësore, statistikatat gjyqësore, procesverbalet e seancave dëgjimore/transkriptet dhe informacione të tjera që tregojnë praktikën e zbatimit të ligjit dhe sistemin gjyqësor. Një gjë e tillë ka ndikim në funksionimin dhe zbatimin e kuadrit ligjor në tërësi. Autoritetet kombëtare të Kosovës duhet të caktojnë një qasje të besueshme dhe</p>

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						gjithëpërfshirëse materialit për hartimin e ligjit dhe praktikës së duhur ligjore lidhur me procedurën penale.
2.6.10 Kryerja e një vlerësimi me rekomandime për shkallën, natyrën dhe ndikimin e moszbatimit të kuadrit ligjor që kërkon përdorimin e xhirologarisë bankare për pagesat mbi 500 Euro, në pajtim me nenin 13 të Ligjit nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe procedurat.	Vlerësimi të bëhet deri më 31.12.2014 dhe rekomandimet të zbatohen deri më 31.12.2018	Administrata Tatimore e Kosovës	Ministria e Financave, Ministria e Drejtësisë, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2018	Jo	Ekonomia e bazuar në para të gatshme rrit ekonominë informale dhe krimet financiare. Administrata Tatimore krahason deklaratat lidhur me shitjet dhe blerjet për të siguruar përputhshmëri me legjislacionin. Megjithatë, ky proces nuk trajton transaksionet e padeklaruar. Kuadri ligjor që kërkon pagesën e pagave përmes xhirologarive bankare është i paqartë (03/L-212 për Punën, Neni 55.4).
2.6.11 Kryerja e një vlerësimi për ti përcaktuar kërkesat ligjore dhe administrative si dhe të krijohet një kornizë e cila siguron që një përfitues i një subvencionit qeveritar të paguaj tatimet e	Vlerësimi të bëhet deri më 31.12.2014, mekanizmat të themelohen deri më	Ministria e Financave	Ministria e Drejtësisë, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2018	Jo	Subvencionet e qeverisë nuk duhet të paguhen nëse përfituesi nuk ka shlyer tatimet dhe detyrimet e të tjera publike. Marrja e financimeve

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
duhura dhe detyrimet e tjera ndaj shtetit para se ta marrë subvencionin.	31.12.2015 dhe veprimi të zbatohet deri më 31.12.2018					qeveritare duhet të ndalohet për një kohë të caktuar në qoftë se një person fizik ose juridik nuk ka shlyer tatimet dhe detyrimet e të tjera publike.
2.6.12 Kryerja e një vlerësimi me rekomandime për shkallën, natyrën dhe ndikimin e manipulimit apo përdorimit të neglizhuar të arkave fiskale (AF) apo faturave të thjeshtuara, siç përcaktohet në nenin 46 të Ligjit për Tatimin mbi vlerën e shtuar.	Vlerësimi të bëhet deri më 31.12.2014 dhe rekomandimet të zbatohen deri më 31.12.2018	Administrata Tatimore e Kosovës	Ministria e Financave, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2018	Jo	Përdorimi i duhur i makinave të mjeteve monetare ose pajisjeve elektronike fiskale (arkave fiskale) parandalon shitjet pa faturë dhe hyrjen të parave të gatshme dhe regjistrave të cilët nga ana e tyre parandalojnë ekonominë joformale.
2.6.13 Kryerja e një vlerësimi të kuadrit ligjor lidhur me shkëmbimin e informacionit ndërmjet autoriteteve të mbikëqyrjes dhe atyre për zbatimin e ligjit për ti identifikuar pengesat e mundshme dhe për të rritur bashkëpunimin institucional sa i përket parandalimit dhe zbulimit të krimeve financiare. Këto autoritete duhet të hartojnë një plan të përbashkët vjetor lidhur	Veprimi zbatohet deri më 31.12.2015	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm	Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, NjIF-K, Banka Qendrore e Kosovës, Agjencia Anti Korrupcion, Policia e Kosovës,	K4 - 2015	Jo	Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse dhe atyre për zbatim të ligjit duhet të rritet për të zhvilluar parandalimin dhe zbulimin e krimeve financiare. Marrëveshjet e bashkëpunimit duhet të përfshijnë plane të përbashkëta vjetore për veprimet, trajnim të përbashkët dhe takime të

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
me operacionet e përbashkëta dhe vendosjen e objektivit për parandalimin dhe zbulimin e krimeve financiare. Autoritetet në fjalë do të ishin Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, Këshilli i Kosovës për Raportim Financiar, Banka Qendrore e Kosovës, NjIF-K, Agjencia Anti Korrupcion dhe Policia e Kosovës.			Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike			rregullta me objektiva specifike.
2.6.14 Kryerja e një vlerësimi ligjor për të shqyrtuar nëse Ligji për Procedurën përmbartimore është në pajtim me kërkesat e mjedisit operacional dhe nëse duhet të nxirret legjislacioni sekondar për të siguruar zbatimin e plotë të tij.	Veprimi zbatohet deri më 31.12.2014	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Punëve të Brendshme, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2014	Jo	Ligji për Procedurën përmbartimore në Kosovë është instrument i ri ligjor, zbatimi i plotë i së cilit është i kyç dhe do të sigurohet duke nxjerr legjislacionin e nevojshëm sekondar për të ndihmuar institucionet relevante në interpretimin e tij.
2.6.15 Kryerja e një vlerësimi ligjor dhe organizativ për të përcaktuar kornizën për një deklaram të detyrueshëm tatimor për kreditë, interesat dhe burimet e financave të përdorura për blerjen e asetëve dhe për investime.	Raporti i vlerësimit përpilohet deri më 31.12.2015	Administrata Tatimore e Kosovës	NjIF-K, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Koordinatori Kombëtar për Luftimin e Krimeve Ekonomike	K4 - 2015	Jo	Auditimet pro-aktive dhe hetimet e pasurisë të pashpjegueshme janë instrumente për parandalimin e ekonomisë joformale dhe pastrimit të parave si dhe për konfiskimin e të ardhurave nga krimi. Duhet të nxirret

Veprimi	Indikatorët kyç të performancës	Institucioni përgjegjës	Institucioni mbështetës	Afati kohor për implementim	Kostot financiare dhe burimet e financimit	Komente
						kuadri i nevojshëm ligjor dhe organizativ për ti lehtësuar auditimet dhe hetimet e tilla.